



Prill 2025

shqiptare

## Bëni gjithçka me perkushtim!

**Tregojuni të tjerëve për shpresën që  
ju plotëson!** (krh. 1 Pjetrit 3:15)

**Kontakt:** Meinolf Wacker  
Kirchplatz 7  
59174 Kamen

**Mobil.:** +49-172-5638432  
**Mail:** [m.wacker@go4peace.eu](mailto:m.wacker@go4peace.eu)  
**Homepage** [www.go4peace.eu](http://www.go4peace.eu)

Të dashur miq të go4peace,

Në këtë vit të shenjtë në të cilin Papa Françesku na fton të udhëtojmë si pelegrinët e shpresës, Edita nga Kosova ndan me ju një “moment të fortë shprese” nga jeta e saj në prill:

“Si një mjeke e re, unë punoj në Kosovë, në vendin tim. Përveç punës, kujdesem edhe për të rinjtë që po përgatiten për një karrierë mjekësore. Në këtë grup studentësh vitin e kaluar ishte një e re që po e kalonte shumë të vështirë në shtëpi. Babai i saj ishte ndarë nga familja, nëna e saj kishte kancer dhe ajo nuk dinte se çfarë të bënte më pas.

Kisha dëgjuar për vështirësitë e saj dhe ndjeva sikur nuk mund ta ndihmoja mjaftueshem. Unë vetëm mund ta dëgjoja atë. Kështu që u përpoqa ta mbaja flakën e shpresës të ndezur brenda saj. Kohët e fundit kam marrë një urim të ngrohtë për ditëlindjen nga ajo: 'Nuk do ta harroj kurrë atë që ke bërë për mua dhe të ardhmen time.' Me dolen lotet sepse mendoja se nuk e kisha ndihmuar mjaftueshem. Por e kisha dëgjuar shpesh me dashuri kur kishte nevojë. Kjo e ndihmoi të ngulmonte dhe të gjente rrugën e saj në jetë.”

Këtë muaj prill le të bashkojmë forcat me Editën me moton: Bëjmë gjithçka me përkushtim!

Per ekipin e go4peace  
für das go4peace-Team Meinolf Wacker

P.S.: Ndani edhe ju eksperiencat tuaja ne aplikacionin go4peace, „Entdecken & Schreiben“.